



ΔΙΕΥΘΥΝΣΙΣ

Tahta Minare Vodina Sokağı No. 42

Istanbul — Fener

ΣΥΝΔΡΟΜΗ ΕΤΗΣΙΑ

ΕΝΤΑΥΘΑ ..... Λ. Τ. 2.50

ΕΝ ΤΩ ΕΞΩΤΕΡΙΚΟ ..... ΔΟΛ. 2.50

Fazilet Basimevi, Galata

Apd. no. 141.682



# Jetëshkrimi dhe akoluthia E DËSHMORIT TE RI DHE ISAPOSTOLLIT

## SHEN KOZMA

Kthyer nga Gërgishtja  
prej Klerikut Orthodhoks





ΑΓΙΗ ΜΑΡΙΑ ΕΙΩΝ ΕΙΔΟΣ ΣΑΤΙ.  
ΕΠΕΡΜΑΣΤΗΡΑ: ΚΑΙ ΙΕΡΑΠΟΛΙΣ ΛΕΙΤΟΥΡΓΙΑ  
ΤΗΣ ΙΔΑΙΑΣ ΗΜΙ ΥΠΤΥΜΕΝΗΣ  
ΛΕΙΤΟΥΡΓΙΑΣ ΜΗΤΡΩΝ. —  
ΕΙΑΝΟΥΜΑΡΑΧΗ ΣΩ. ΓΥΡΑΙΟΝ ΟΙΚΟΥ  
ΟΣ ΤΟΙ ΕΝΙ ΕΦΕΒΑΥΟΥ: ΖΑΧΑΡΙΑ  
Ι ΤΕ ΕΘΟΥΝ ΚΑΙ ΤΑΞΙΔΙΟ



# PARETHÉNJE

Në mbarimin e shekullit t' tetmëdhjet Krishterimi i Shqipërisë kishte arritur në një rezik shum të math. Nga padja e thell e popullit, nga shtypjet e qeveritarvet t' asaj kohe, nga tmeri që mbretëronte nëpër të Krishterët, jeta dhe pasunia e të cilët varësh prej mëshirës së më të fortvet, renegacionet ishi i gjëra të shipeshta dhe të zakonëshme. Shum herë gjante që vise të tëra ndërrronin Fe për shkak e pa rëndësi.

Në këtë gjendje ardhja e Shën Kozmajt shënoj një stacion tepër importent për fatin e Krishterimit në Shqipëri.

Posi një Apostoll i ri, i mbushur me entuziazmën e Frymës së Shenjtë dhe me zëmërnxehtësin e Profitvet, kjo orator i shkëlqyer i Ungjillit, u përpooq me fjalimet e tij të larta dhe të ëmbla t' u jap zëmër dhe kurajo të Krishtervet të terorizuar të athershëm dhe t'i përbante një traditat fetare atnore. Munt të themi sigurisht se, dhe ato taproja të pakta të Krishterimit që mbeten sot në Shqipërin e Jugut, u detyrohen këtyre veprimeve.

Merita më e madhe e Shenjtit dhe lartësia e tij tregohen nga kujdesija e veçantë që çfarqte përkulturën e popullit. Kur vizitonë një katund e se qytet për të predikuar, mendimi i parë i tij ishte të hapte shkolla, në të cilat djemt e të Krishtervet merrin edukatën darovisht.

Sa influencë të madhe ekzerconte Shën Kozmaj kudo që vinte, duket dhe nga një dorëshkrim që ndodhet gjer sot në mifletën e një Mineoje të

vjetër të Kishës së Shën Gjergjit të Kalas Beratit, të botuar në Venetik më 1761. Në këtë Mineo, midis shënimeve të tjera, janë shkruar dhe këto:

1777 Ektise o Amet Pashas to gjofiri stin Çukasi.

1777. Min Avgustos 22. Imera Triti. Ilthen o asqitis qe mas. edhidhaksen imeras tris, kalumenos Kozmas Jeromonahos, qe ekopse ta asimia tes gjineqes.

1778. Ektisthi to gjofiri edho stin Gorica, is tuto to etos evalan qe ta ambelia stin bifta.

Min Junios 5 Imera Triti. Evrekse vrohi me-gali qe irthan tus laku qe emviqe to nero sta ergastiria.

Shënim' i sipërmë që flet për Shënjin, tregon sa përshtypje të madhe i bëri popullit ardhja e tij në Berat, për të Krishterët e të cilat, u konsiderua si një ngjaje istorike.

Botojmë tash jetëshkrimin e Shën Kozmajt, original' i të cilat është shkruar prej një kontemporenë, të tij, që e kishte dëgjuar vet, tue u rezervuar të kthejmë më tutje dhe fjalimet e tij, të cilat, për fat, gjenden në Bibliothekat e Monastirevet të malit t' Shenjt. Më në funt botojmë dhe dy letra të Vezir Ali Pasha Tepelenës, me të cilin, si ç' është editur, Shenjti kishte lidhur relacione që në kohë kur Satrapi i përmëndur i Janinës ishte edhe një Bej i vogël në Tepelenë. Këto dy letra, të mara si duket nga Arhivet e Mitropolisë së Beratit, janë shtypur për herën e parë prej ish Mitropolitit Bë-



ratit Anthimit në librën e tij përmbi Eparhin Velegradhon. Letra e tretë për të Krishterët e Selenicës gjëndesh në vitin 1900 në duart e Dhjakut t' atheroshëm të Mitropolisë Gjinokastrës Sofronit.

Si ç' ësht e ditur, shkrimtarët bashkohës të Ali Pashës përshkrojnë hollësisht relacionet e tij me Shën Kozman, i cili e kishte njojur Alin që në djalëri dhe i kishte parëthënë të gjitha ngjarjet e jetës së tij dhe se një ditë do të bëhej princ i math dhe i dëgjuar në gjith botë.

Një kso episodi e shënon G. Ikonomu, sekretar i Aliut, siç pason:

Një ditë, thot i përmënduri G. Ikonomu, në portën e Sarajevet të Janinës u prezantuan dy kallogjer me një kuti të artë në dorë, e cila përbante eshtrat e Kres së Shën Kozmajt dhe kërkuan lejë që të çfaqëshin përpara Pashajt. Kur u lajmërua Aliu, i cili n' atë orë po rrinte, simbas zakonit, i shtritur në dhomën e tij dhe po kuvëndonte me një sheh nga klerikët e lartë të Janinës të quajtur Haxhi Shehri efendi, dha urdhër me një herë që të hynin kallogjerët brënda dhe të agjasnin dhomat e Qira Vasiliqis dhe të gjitha odat e Sarajevet. Pastaj i thëriti në dhomën e tij dhe, posa që u çfaqë, u ngrit nga vëndi, mori në duart kütin me Kren e Shenjtit, e puthi me respekt dhe e vendosi mbi nëkresën e tij. Kjo gjë i bëri përshtypje Sheh Haxhi Shehriut, i cili çfaqi habitjen e tij, tuke thënë:

— Istafullah, efendim, Istafullah, domethënë



— 6 —

ç' ësht ky mekat që bën?

— Po, po! sa i marr qënke or Sheh, i përgjigjet Aliu i zëmëruar. Nuk do të kishje thënë këtë fjalë, po të kishje ditur ç' njeri ishte kjo. Kjo kallogjer, or Haxhi, ka qënë Profit i vërtet, vallahi, Lilahi. Mua n'i ka dëfyer të gjitha ç' më kanë u ngjarë gjer sot, sikur i kishte kënduar në qitap. Vëtëm një gjë më mbeti merak që nuk e pyeta cili do të jetë fundi im.

Me të thënë këto fjalë Ali Pashaj e mori dhe një herë kutin e putni përsëri dhe u a ktheu kallogjervet, ue i darovitur me një grusht rrubijera (monedha të florinjta).

Pra, këtë librëz të gjith të Krishterët duhet t'a kenë kurdoherë me vehte dhe t'u a këndojnë fëmijëvet të tyre, sepse këtu do të shofin veprimet e shkelqyera të një personi të nderçëm dhe të lartë, i cili dispozoj tër jetën e tij për shërbimin e së vërtetës, për mësimin e popullit dhe më në funt derdhi gjakun për idealismën e Krishterimit.



# Jetëshkrimi i Dëshmorit te Ri dhe Isapostollit Shën Kozmajt.

## Këthyer prej Gërqishtjes

Kjo mësuës dhe predikuës i shkëlqyer i Ungjillit t' shenjt Shën Kozmaj, që ka qënë vërtet njeri i Perëndisë, ishte nga një fs'at i vogël i Etolisë, i quajtur Mega Dhendhron. Tua qënë prej shtëpije të mir dhe bir prindërve besnikë, mori që në vogëli eduka'ën e duhur fetare, simbas fjalëvet të Shën Pavlit dhe kur arriti në moshën e 20 vjeçevet, a pak më tepër, filloj mësimet e Literaturës nënë mësuësin e dëgjuar të asaj kohe Ananian, të memruar Dervishan. Me qënë se n' atë kohë e sipër u hap dhe mori një nam të math shkoll' e Vatopedhit t' Malit Shenjt, u ngrit e vajti në këtë shkoll, i shoqëruar prej shum bashkënxënësve të tij. Atije mbaroj Literaturën pas mësuësit Parajot Palamajt dhe mas kësaj mori mësimet e Llogjikës prej Nikoll Xhurxhulit nga Mecova, i cili, pas dorëheqjes prej asaj shkolle të dijetarit t' math Evgjenit, u emënuar drejtor i saj. Sa do që ishte akoma kozmik i quajtur Konsta, po dukësh i stolisur me përu-njësin e formës murgore dhe përpinqësh të ushtron-te vehten me ç' do mënyrë që të perfekcionohësh në virtutat e murgërisë. Po, tua qënë se dhe ajo shkoll mjerisht, pas dorëheqjes të mësuësve t' saj të dëgjuar, u shkretua dhe katandisi si ç' qe më parë, prandaj iku s' andejmi dhe Konsta dhe vajti



në Monastirin e shenjtë të Philotheut, ku u dorëzua mërg dhe i u përvesh me zelë të math mundimëvet të jetës murgore. Atije, me qënë se Monastiri kishte nevoj për prift, tue u bindur çortimevet dhe lujevet të etënvët t' shenjt, u ordinua dhe mori ofiqin e pristërisë.

Pra i lumturi dhe në kohën që ishte edhe kozmik, kishte, sikundër tham, në zëmrën e tij zelë të math që t' u bjer dobi vëllezërvet të Krishterë nga ato që kishte mësuar vet. Shum herë thoshte, se vëllezërit t' anë të Krishterë kanë nevoj të madhe të dëgjojnë fjalën e Perëndisë dhe ata që kanë pasur fatin të bëjnë studime, duhet të mos rendin nëpër Pallatet e oborret e të mëdhenjvet dhe të kotësojnë studimet e tyre për të fituar të holla dhe ofiqe, po të mësojnë shumicën e popullit, që jeton në mizori dhe padije të thell, se ashtu mundim' i tyre do të shpërbleshet me lavdi qellore dhe të pafikur.

Po donëse zëmra e tij digjësh prej një zeli të nxeh të për t' i prurë dobi popullit, prap, nga shkaku që ishte shum i përunjur dhe i matur dhe mendohësh sa gjë e madhe dhe e vështirë ësht puna e predikimi, nuk guxonë vet vetiu të merte përs përkëtë veprë të rëndë, pa mar vesh mir dhe dëshirën e Perëndisë. Pra një ditë tue dashur të provonj në qoft s' kjo punë që kishte ndër mënt ishte dhe me dashjen e Zotit, hapi shkronjat e Shenjta dhe çuditërisht përpara tij u giendën fjalët e Shën Pavlit që thot: "As njeri le të mos kërkonjë vëtëm atë që intereson vehten e tij, po gjithkush



të kujdeset dhe për tjatrin.” Me fjalë të tjera Shën Pavli do të thot se, njeriu në botë nuk duhet të përpigjet vetëm për interesat e vehta, po dhe përvëllazërit e tij. Pra si u bind prej këtyre fjalvet, u çfaqi mendimet e tij etënve t’ shenjtë të Monastirit, mori ndjes prej tyre dhe shkoj në Stamboll përrë takuar vëllan e vet Hrisanthin, mësuës n’ atë qytet, i cili i dha dhe ca mësime të mjeshtërisë oratorike që të predikonj methodhikisht. Atije u rrëfeu mendimet e tij Episkopvet dhe mësuësvet që gjendëshin n’atë kohë në Stamboll dhe kur pa që të gjith e inkurajuan në këtë punë, mori prej Patrikut t’ asaj kohe Serafimit lejë të shkruar dhe filloj predikimin e Ungjillit të Mbretërisë Qellit më përpara nëpër Kishat dhe fshatrat e Stambollit, pastaj vajti në Nafpaktion, në Vrahorë, në Mesollongji dhe në vise të tjera dhe pasi mbaroj këtë shëtitje, u këthye prap në Stamboll. Atije u këshillua me Patrikun e asai kohe Sofronin, mori lejë të re dhe bekimet e tij dhe filloj përsëri predikimin e Ungjillit t’ Shenjt me nxehësi më të madhe se më parë. Këtë herë shëtisi 12 nisirat, tue mësuar të Krishterët të pendohen dhe të bëjnë punëra të merituëshme të pendimit. Pastaj u këthye prap në Malin e Shenjt, ku vizitoj Monastiret dhe Sqitet, predikoj nëpër murgët dhe më në funt ndenji ca kohë në to, për të kënduar librat e larta të etënvet t’ shenjtë. Por mbassi dashurija ‘që kishte në zëmër përt’ u dhënë drit të Krishterët nuk e linte të qëndronte atije më tepër, sikundër ju thoshte shum



herë dhe etënvet, u ngrit prap s' andejmi dhe shkoj për të predikuar në Selenik e në Veri, dhe shëtisi afër gjith Maqedhonin. Më pas hyri në viset e Himarës, të Akarnanisë, të Etolisë dhe arriti gjer në Artë dhe në Prevezë. S' andejimi lundroj në Agjia Mavra dhe në Qefalini.

Kudo që vinte i shumlumouashmi Shën Kozma pështilleshin të Krishterët nga ç' do anë për të dëgjuar me bes dhe përvujtëni, fjalët e tij të ëmbla dhe të hiëshme, dhe pës këllj mësimi realizohesh një përmirësim moral dhe shpirtënor i math. Fjalët e tij, të cilat i dëgjuam dhe vet, ishin fare semplë dhe të lehtkuptuarshme, si ato të peshkaxhinjvet. Ishte i qetë dhe i urtë, ashtu që shpirt'i tij dukësh i mbushur prej frymës së Shenjtë. Sidomos në Qefalini mësuës i shquar pruri fruta të mëdhq me farët e predikimevet t' tij, të cilat Perëndia që lart i konfirmonte me çudira të ndryshme, sikundër një herë moti predikimet e Apostojvet:

Në këtë nisi jetonte një rrobaqepës i vohekt, i cili kishte dorën e djathtë të thar që prej shum kohe. Kjo pra rendi tek Shenjti dhe i lutësh që t'a shëronte. Ai e çortoj të vazhdonte me bes në fjalimet e tij dhe e shiguroj, se Perëndia do të bënte mëshirë për të. U bind i sëmuri dhe o çudi! më të nesërmen u gjent i shëruar fare.

Një tjatër, i goditur pëj paralisie të gjith trupit, posa që mori vesh këtë çudi, kërkoi që t'a shpinin me gjith shtratin përpala Shenjtit atë orë që fliste dhe pas disa ditve dhe kjo u bë i shën-



dosh dhe shkoj tue lëvdëruar Zotin dhe tue falnderuar Shën Kozman.

Në Kështjellën e Astros, një nga fisnikët e vëndit vuante nga një sëmundje e rëndë të veshvet, nga shkaku i së cilës kishte humbur dëgjimin që prej shum vjetve. Kjo vajti me bes dhe mallngjim atije ku predikonte Shenjti dhe atë çast nisi të dëgjonte mir dhe q' atëhere mbeti i shëruar.

Në Qefalini ësht një katundë i quajtur Kuruni. Një ditë të Pranverës Shën Kozmaj shkoj nga kjo katund dhe me qënë se ishte i etuar, kërkoj t' i jepnin uj prej një pusi që ishtë aty pranë, i cili ishte i thar. Katundarët i thanë se pusi nuk ka uj, po me gjith këtë, për të rrëfyer bindësi, qitën një kovë me uj, e cila ishte plot me halt e shurr dhe ja prunë. Pra posa që Shenjti e vuri në goj dhe piu pak, u bë çudia dhe q' atëhere filloj të buronte uj e kulluar nga pusi, i cili gjer sot ësht plot me uj dhe shërohen prej tij shum sëmundje.

Nga shkaku i gjindjes së madhe që mblidhësh në fjalimet, që nuk muot t' i nxinte asnjë Kishë, Shën Kozmaj i bënte nevojërisht predikimet jasht në fushë dhe kishte zakon, para se të niste predikimin, të porositte të ngrihnin n' atë vënt një Kryq të math. Në këtë Kryq mbështette shkamin që ja kishte ndrequr, si thonë, Kurt Pasha, mbi të cilin hipte dhe predikonte. Në mbarimin e fjalimit e shkrihte prap shkamin dhe e merte me vehte kudo që vinte. Sa për Kryqin, ai mbiste n' atë vënt si një kujtim i gjithnjëshëm i fjalimevet t' ijj.



Pra në ato vënde ku ishin ngritur Kryqet Perëndia vepronë shum çudira. Kështu në Argostol, që është qytet i Qefalinisë, n' atë vënt ku ishte lënë kryqi i Shenjtit dolli një burim i çudiçëm që ekziston gjer sot, pa u pakësuar fare vjt' e tij.

Nga Qefalinija shkoj në Zaçinthon, i shoqëruar prej më shum se 10 kaikeve, plot me besnik Qefallonit, por në këtë nisi nuk i vajti kaq mbar puna të bekuarit, prandaj pas disa fjalimeve që bëri, u këthye prap në Qefalini. S' andejmi vajti në Korfus, ku u prit me nder të math prej gjith popullit dhe sidomos prej Princit të Korfuzit. Po nga shkaku që mblidhësh nga fshatrat një shumicë e madhe për të dëgjuar mësimet e tij, parësia e qytetit i u lutën që të largohesh sa më shpejt dhe kështu për mos t' u bërë shkaktar skandaleve dhe trazirave në mes të popullit, iku s' andejmi dhe u hoth përtej në Stere, domethënë në Shqipëri, në vëndin e quajtur Agjii Saranda. Këtu vazhdoj predikimet dhe shëtisi të gjitha këto vise barbarike, në të cilat feja dhejeta morale e të Krishtervet kishte arritur në një rrezik të math nga skkaku i padiges së thell të tyre dhe nga ligësirat, vrasjet, dhe paudhësirat e panumërtë që bënë gjer në një gradë sa ishin bërë më të liq se të pabesët. Pra tue hedhur farën e Perëndisë në zëmrat të egërsuara dhe të pakulltivuara të këtyre të Krishterve i shenjti Kozma, pruri me ndihmën e Zotit fruta shum të mëdha, sepse të egërit i zbuti, çegërsoj kusarët, zëmërgush-tët i bëri të mëshirshëm, të pabesët besnikë, të paditunvet dhe trashanikvet i u mësoj punët e Perëndisë



dhe i bëri që të rendin të gjith nëpër akoluthirat Kishëtare dhe me pak fjalë të gjith mekatarët i pruri në një pendim dhe ndreqje morale të madhe, sa që të gjith thoshin se u çfaq një Apostoll i ri.

Me fuqin e mësimevet të tij ngriti shkolla qytetse dhe fillore, nëpër qytetet e nëpër katundet, që të vazhdonin në to djemt darovisht, ashtu që më nj' anë të forcoheshin në besën dhe fetarizmën dhe m' anë tjetër të udhëhiqëshin në jetën morale dhe të virtutavet. Të pasurit i bindi të blinin nji mij kolinvithra të bakërtë nga 12 grosh njëra, të cilat i afierosën në Kishat për kujtim të përhershëm të tyre dhe për t' u pagëzuar në to si duhet djemt e të Krishtervet.

Gjithashtu kandisi shum nga të pasurit të blehin libra të etërvet t' shenjtë, mësime fetare, kombollogje, kryqe të vegjël, mbulesa dhe griba. Librat ja u jepte atyre që dinin të kondonin ose që zotoheshin të mësonin këndim, mbulesat më tepër se 40000 ja u dha gravet që të mbulonin kryet dhe gribat atyre që kishin taksur të linin mjekrën dhe të jetonin moralisht dhe Krishtenisht. Kombollogjet dhe kryqet e vegjël më shum se pesqint mij ja u ndau popullit, që t' jipnin ndjes blerësvet.

Kishte nja dyzet a pesdhjet priftër që i vinin pas dhe kur shkonte nga një qytet në tjetër, më përpara porositte të Krishterët të nunëroheshin, të agjeronin dhe të bënë agripni dhe drithdezje të madhe. Për këtë qëllim kishte goditur enkas manuale të drunjta që mbante gjithsecila nga 100 qj-



rinj dhe kur mbaronte predikimin i shkrihte dhe i merte me vehte. Pastaj u ndante qirinj të gjithve, vinte priftërit të këndonin efqeli dhe të hrisnin të gjith të Krishterët dhe më në funt fillonte mësimet. Të qenë se mblidhesh gjindja e madhe, dy a tri mij, prandaj urdhëronte që më dark të pregetitnin shum thas me buk dhe kazane me grurë të zjer, të cilat e shpinin atje nga do të shkonte populli dhe kështu mernin të gjith dhe u jepnin ndjes të gjallvet dhe të vdekurvet.

Pra si nëpër vënde të tjera ashtu dhe në Shqipëri Perëndia me fuqin e tij bëri shum çudira:

Një Oficer turk, i shtytur prej Izrailitvet ose prej të ligut, e urente kaq shum Shenjtin sa që një ditë i hipi kalit dhe u çua që t'a zinte dhe t'a malfetonte. Po tue rendur kali e rrëzoj dhe theu këmbën e djathëtë dhe kur vajti në shtëpi gjeti të birin të vdekur. I penduar për veprimin e vet të dobët i shkroj Shenjtit një letrë dhe i kërkoj ndjes.

Në Filjatë agallarët vajtën t'a shinin dhe t'i dëgjonin fjalimin dhe me qenë që ish'e pranverë, fjetën në fushë, ku ora më pes të natës panë një dritë qellore, posa një re të ndriçme e cila mbulonte vëndin ku rrinte Shenjti, gjë të cilën ja u rrëfyen të Krishterët. Pra posa që u gëdhi i u lutën Shën Kozmajt t'ju jepte uratën me gjith zëmër dhe jo me goj vetëm.

Një oficer turk tjetër nga Kavaja, vuante prej një sëmundjeje të rënd dhe nuk bënte dot ujt. Kjo



kur mori vesh për Shën Kozman, i dërgoj shërbëtorin dhe i u lut që t'i vinte në sh'ëpi dhe t'a këndonte, se nofta me ndërmjetimin e tij do t'a shëronte Perëndia. Po Shën Kozmaj nuk desh të vinte, tue quajtur vehten mekatar. Për së dyti oficeri i dërgoj shërbëtorin me një enë me uj dhe i u lut që t'a bekonte. Atëhëre kur pa fetarizmën e turkut Shën Kozmaj i dha dy porosira: E para që të mos pinte më raki dhe e dyta që të ndante të dhjetën e pasunisë nëpër të vobektët; dhe kur i u zotua se do t'i ruante këto dy porosira, ja bekoj ujët. Pra posa që e piu këtë uj i sëmuri u shërua fare dhe bëri shum sevape.

Një turk tjatër nga një vënt i quajtur Lakuris, nga zyrtarët e këtij vëndi, tue parë kryqin që kishte lënë Shenjti, simbas zakonit që kishte, e nxori nga vëndi dhe e shpuri në shtëpin e vet me qëllim që t'a përdorte në vënt të dy shtyjevet të shtratit t' tij. Po q' atë çast, o çudi! u bë si një tërmet i math dhe tue mos mundur ai turku të qëndronte më këmb, ra mbërdhe dhe po zvarosësh shum orë, po kërcëllinte dhëmbët dhe po nxirte shkum nga goja si i xhindosur. Pastaj, pasi dy turq të tjerë që shkonin andej, e ngritën, dhe erdhi në vehte, e kuqtoj që këtë gjë e pësoj prej zëmëratës së Perëndisë nga shkaku i guximit që riëfeu dhe nxori kryqin e nderçëm. Pra vajti vetë dhe e ngulji prap n' atë vënt ku ishte me përpëra dhe ditë përditë vinte dhe e puthë me bes të madhë. Dhe një ditë tjatër, tek shkonte s' andejmi mësuësi i shenj-



të, rendi vet turku përpara tij, i ra ndër këmb dhe i u rrëfente të gjithve çu ëndin që pa, tue kërkuar ndjes dhe përunjësi.

Tue qënë se Shën Kozmaj i qërtonte grat që mbanin stolira, i kandisi me fjalët e tij që t' i linin të gjitha stolirat, sa që ca nga ato mvisheshin me të zeza. Një grua e pasur në Korçë kishte një djal, kryet e të cilit ja stoliste me shum florinj dhe të tjera stolira të tepra. Këtë grua Shën Kozmaj e këshilloj shum herë që t' i shpërndante stolirat nëpër djemt të vobektë, në qoftë se dëshiron te jetën e djalit. Po ajo nuk u bind; atëhere i tha dhe një herë që po të mos vepronë pas fjalvet t' tij e kishte për të humbur për së shpejti. Pombasi dhe këtë radhë gruaja nuk dëgjoj, më të nesërmen e gjeti djalin e saj të vdekur në shtrat dhe atëhere kuptoj se Perëndia e dënoj për pabindësin e saj.

Gjithashtu Shën Kozmaj u predikonte të Krishtervet që të mos bënin ditën e Djel pazar, as punëra të tjera, po të vinin në Kishë dhe të dëgjonin fjalët e Perëndisë dhe ata që nuk dëgjonin dënoheshin prej Zotit me mundime të ndryshme. Pra në një vënt të quajtur Halqiadhes, një orë lark nga Arta, një tregëtari, që nuk ju bint porosisë së Shenjtit dhe kuxoj të bënte tregëti ditën e Djel, i u tha dora gjer sa e ndjeu fajën e vet, rendi tek Shën Kozmaj dhe i kërkoj ndjes dhe kështu u shëtua prap pas pak ditve.

Në Pargë një dyqanxhiu që dësh të shistë ça



plaçka ditën e Djel. i u zu dora. Po masi e nohoj mëkatën e tij përpara Shën Kozmajt dhe mor ndjes, gjeti shërim. Në Ksironerë qëlloj që një grua gjatë ditën e Djel. Kjo kur rxori bukën nga furri e gjeti të kuqe sëkur e kishte gatuar me gjak. Pra i ra ndërt këmbë Shenjtit dhe mori ndreqen e duhur. Në vise të tjera, ku nuk rrëfenin respekt për të Djelën, njërit i plasi kau, tjedrit pela, kush u bë i xhindosur dhe kush gjeti djalin e vet të vdekur.

Në një fshat të Kastorisë të quajtur Selx, një grua që kishte shum evllavi tek Shenjtë, mori ujën me të cilën Shën Kozmaj kishte larë sytë dhe e ruajti në një enë të qelqët. O çudi! Brënda n' atë enë mbiu një bim me dy gjethë vetëm, e cila u rrit dhe u madhua barazi me enën, mbi të cilën lundronë pa pasur fare rrëz. Dhe ngjyra e saj nuk u ndryshua aspak, po mbeti e freskët një mot të tërë, sa që të gjith e shikonin dhe çuditëshin; dhe ajo uj bëri shum çujira, siç kallzonte vet gruaja fedashëse. Këto dhe shum mrekullira të tjera bëri Zoti me anën e Shën Kozmajt, të cilat neve, për të shkurtuar fjalët, nuk i kujtojmë të gjitha.

Shën Kozmaj shum herë në fjalimet e tij thoshte, se e thërriti vet Zoti Krisht në këtë punë të predikimit dhe se një ditë për dashurin e tij do të derhtë gjakun. Pra këto fjalë profitike i duallën pikërisht, sikundër tha dhe u vërtetuan me niényrën e pasme:

Ky mësuës i math dhe apostolik kur ndonjë herë nuk kishte hapur gojën kundra izrailityvet.



në Selenik, as në Kastori, as në Janinë, as në donjë vënt tjatër, po kurdoherë porosilte të Krishterët të silleshin Krishterët, të jenë të singert dhe besnik ndaj sundimtarët e tyre, që i u ka caktuar Zoti, ashtu që dhe Shqiptarët vet, që vini n jasht në fushë për t' a dëgjuar, i dëgjonin këto fjalë nga goja e tij vet, dhe e kishin si njeri të Perëndisë, gjer n' atë gradë sa Kurt Pasha, kur mori vesh namin e tij, dha urdhur që t' ja prezantonin përpara dhe kaq shum u kënaq prej fjalvet t'tij, sa i ndreqi, sikundër tham, atë Shkam dhe ja mveshi me kadife, që të hipte mbi të dhe të predikonte popullit së larti. Po fis' i lik dhe i vështirë i izrailitvet, sikundër gjithmonë në shekujt e shkuar kanë çfaqur kundra të Krishterët ligësirën më të madhe, kështu dhe tani, tue mos duruar që të predikohet besa dhe Ungjilli i Zotit t' onë Isu Krisht, izrailitet, thash, perëndindjekës të Janinës, vajtë tek pashaj vëndit dhe i thonë se gjoja mësuësi i dëgjuar Kozmaj ishte dërguar prej Moskovivet që të pllanepte rajan e mbretit, me qëllim që të vini në Moskovi. Këtë radhë Shën Kozmaj shpëtoj nga kjo shpifje e rezikshme, po n'i anë tjatër të Krishterët i u bë dëm i math nga të hollat. Pra q' atëhere Shën Kozmaj nisi një luft të madhe kundra ligësiravet dhe urrejtjes të papajtuarshme që kanë izrailitet kundra të Krishterët; dhe mësi u provua qarisht se kallzimi që bënë tek pashaj ishte shpifje e ndrequr qëllimisht, vajti prapë në Janinë, ku pik së pari kandisi të Krishterët t' a këthe-



nin pazarin ditën e Shtunë në vënt të së Djelës, gjë e cila i u sh'kaktoj izrailitet dëme shum të mëdha. Për së dy'i i dekllaroj armiq të hapët, që në ç' do kohë janë gati t'u bëjnë të Krishterët ç' do ligësia. Për së treti, për të bindur të Krishterët të iqnin xhufkat që blin nëpër izrailitet, u thoshte se ato ishin të ndyra dhe se ata i ndytin, dhe kështu i bëri që të mos blinin më në ta.

Pra izrailitet, tue mës duriuar të shinin dhe të dëgjonin Shën Kozman t' i lëftonjë me këtë mënyrë, vajtën tek Kurt Pashaj dhe i dhanë një sumë të madhe të hollash, që t'a nxjerin ngajeta. Ky u muar vesh me Hoxhën e tij dhe vendosi që t'a vriste me anën e këtij, gjë e cila u realizua me mënyrën e poshtme:

Shën Kozmaj kishte zakon, kudo që vinte përtë predikuar, të merte më parë lejën prej Dhespotit t' vëndit ose prej veqilvet t' tij; gjithash'tu dërgonte të krishterë, të cilët mernin lejën nga ceveritarët e vëndit dhe kështu bënte fjalime pa asnjë ndalim. Kur vajti në një katundë të Shqipërisë të quajtur Kolkondas, mori lejën prej Dhespotit t' vëndit. Pastaj pyeti cilët janë qeveritarët dhe mori vesh se n' ato vënde sundonte Kurt Pashaj, i cili selin e kishte në niq që tet të quajtur Berat, 12 orë lark nga Kolkondasi. Pastaj tue mar vesh se Hoxha i Pashajt banonte aty pranë, i dërgoj një njeri, mori lejën dhe predikoj. Mir po nuk ishte i kënaqur dhe u mendua, për t'u sigruuar më mir, të vinte vet tek Hoxha. Të Krishterët e ndalonin dhe i thoshin



Se kurr ndonjë herë nuk kishte bërë një gjë të këtillë, që të kërkonte vet lejën prej qeveritarvet, po nuk që e mundur t' a bindnin Më në funt Shën Kozmaj, pasi i u tha të mos përzihen më në këtë çështje, mori katër kallogjer dhe një prift si dragoman dhe vajti tek Hoxha.

Hoxha i thot se majde kishte letrë prej Kurt Pashajt, i cili e urdhëronte që t' ja dërgonte Shenjtin në Berat, se gjoja dëshironte të kuvëndonte me të. M'anë tjatër porositi njëzit e tij t' a ruanin Shenjtin dhe gjer sa t' a dërgonte tek Pashaj, mos t' a linin të dilte nga oborri. Pra atëherë predikuës i bekuar kuptoj se do t' a vrisnin, dhe lavduroj e falndëroj Zotin Krisht që e meritoj të imbaronte udhën e predikimit si dëshmor. Pastaj tue u këthyer murgvet që e shoqëronin i u tha fjalët e psalmistit "Shkuam përmes ujt dhë zjarrit dhe n'a nxore në dëfrim" dhe tër atë natë lavduronë Zotin me psalme, tue mos çfaqur as një shënj hidhërimi, po përkundrazi kishte "fytyrën të qeshur, sëkur do të vinte në gjëzime dhe në zbavitje.

Kur u gëdhi, e muarën shtat turq xhelat dhe e hipën mbi një kalë, gjoja sëkur do t' a shpinin tek Kurt Pashaj. Po kur u larguan nga dy orë, e prunë në një vënt ku shkonte një lumë i inath dhe atije, pasi e zhritën nga kali, i rrësyen urdhërin që kishin nga Kurt Pashaj që t' a vrisnin. Shën Kozmaj e priti me gjëzim këtë vendim dhe i u fal Zoti dhe e lavduroj se për dashurin e Tij u meritua të theroronj jetën, sikundër e kishte dëshiruar kurr,



— 21 —

doherë shpirt' i tij. Pastaj u ngrit dhe bekoj kryqësisht të katër anët e lloës dhe u lut për të gjithë Krishterët që të ruanin porosit e tij. Xhelatët e prunë afër një peme dhe deshën t' i lithnin duart, po Shën Kozmaj nuk i la, tue thënë se nuk kishte me u kundërshtuë dhe i kryqësoj duart sëkur ishin lidhur. Pastaj mbështeti kryet e tij n' atë dru dhe barbaret i shkuan litarin në gryk, dhe posa që ja shtrënguan litarin, shpirt' i tij fluturoj në qell, dhe këshfu i tërlumnuarshmë Kozma, ai njeri kaq i dobishëm që ishte vërtet stoli në botë, "u mërikuai" të mar dy kurora së bashku, si isapostoll dhe si dëshmor, tue qënë në moshiën e 65 vjeçeve. Xhelatët pasi e çveshën alipsanën e tij të Shenjt, e hënë në lumë me një gur të math në gryk.

Kur e muarën vesh këtë gjë të Krishterët renden shpejt që t' a nxirnin nga lumi, po sado që e kërkuan me rrjeta dhe mjete të tjera, nuk e gjeten dot. Pas tre ditve një prift besnik, i quajtur Papa Marko, efimer i Kishës Shën Marisë të katundit Kolkondas, që ishte pranë lumenit, hyri në një lundrëz, dhe pasi bëri kryqin, u nis për t' a kërkuar, dhe përnjëheresh, o çudi! shëh alipsanën e Shenjtit që po lundronte mbi ujërat dhe po qëndronte. Ngrihet sëkur ishte e gjall. Q' atë çast rendi, e përgafoj dhe e nxori nga ujt, dhe tek po e ngrihte, prodhi nga goja mjaltderdhëse e Shenjtit shum gjak prënda në lum. Pastaj e mveshi me rason e vet he e pruri në Kishën "Hyrja e Shën Marisë" ku varros në Nartikan të asaj Kishe, në ditët e



Dhespotit Bera'it Joasafit, i cili ndodhi dhe vet në varrimin e Shenjtit.

Pra pas vdekjes së tij rrrodhën sa pasojnë:

Kur Pashaj u pendua se u gënjye dhe për një fitim të kot shkakëtoj vraçjen e një njer'u të qetë dhe të pafajshëm. Pra urdhëroj hoxhën e tjetër që kalllogjerët e Shenjtit, të cilët ai i mbante, t'i linte të lirë të shkonin në Monastirin e Shën Marisë dle të qëndronin atije. Këta kur vajtën në Monastirin në fjale, e gjetën Shën Kozman të varrosur, po përt' u informuar më mir mbi mundimet që hoqi, e qitën nga varri bashk me ca pristrinj dhe të Krishterë të tjerë dhe sado që kishte mbetur tri ditë në lumë, si Jonaj në barkun e peshkut, nuk kishte asnje ndryshim, po dukësh sëkur po flinte, dhe nga gjith trupi i tij dilte një er' e mir. Pra pasi e puthën me përvujtëni e kallën prap n' atë vënt, ku u ngrit Kisha e shenjt, që nderohet me emrin e tij.

Pra Kisha dhe Monastiri u ngritën me mënyrën që pason:

Kur ishte gjall Shën Kozmaj tek shëtiste një herë nga viset e Tepelerës, u poq me Vezir Ali Pasha Tepelenën, i cili n' atë kohë ishte edhe Bej dhe ndiqësh prej Kurt Pashës. Pra Shën Kozmaj, kur takoj me të, i tha se oxhaku i tij do të rritësh shum dhe një ditë ai do të bëhesh princ i math dhe i dëgjuar në gjith boçën; që do të pushtonte shum qytete dhe tër Shqipërin dhe që pas ca kohë do të merte dhe atë selin e Kurt Pashajt. Pas tridhjet vjetve afër, këto parëthënjet e Shenjtit u realizuan, dhe i tërfuqishmi Vezir Ali Pashaj, shke-

Li një ditë dhe atë qendron e Kurt Pashajt, simbas fjalvet të Shën Kozmajt. Pra kur hyri në Berat Vezir Ali Pashaj, ju kuituan këlo fjalë dhe thërriti Dhespotin e Beratit, të nipin e atij që ishte në kohën e Shenjtit. të cilin e porositi të bënte anakomidhi e Shenjtit dhe të ngrihësh një Monastir mbi emërin e Shën Kozmajt, sepse e njoihu si vërtet njeri të Perëndisë, jo vetëm për parëthënjet relative me të, po dhe për gjëra të tjera.

Pra pas ca kohe u bë anakomidhi e Shenjtit, krena e të cilat u argjentua me urdhërin e lartësisë së tij të Princit Vezir Ali Pashajt. Gjith n'atë kohë dha urdhër që të bëhet një ndihmë i përgjithshëm për të ngritur Kishën e famshëm në emërin e Shën Kozmajt. Kështu pra kjo Kishë e shenjt u ngrit që në themelitë me ndihma dhe pas urdhërit të tërfuqishmit dhe të lartit Vezir Ali Pasha Teپelenës, në kohën e Dhespotit Velegradhon Joasafitit të nipit të ish Mitropolitit Joasaf.

Atë orë që e qitën nga varri, u rdoth atje një grua e dhemonisur, e cila nga vise të largëta i vinte pas Shenjtit kur ishte gjall, tue dëshruar shërimin e saj. Kjo grua kur pa që hapën varrin e Shenjtit, u trondit fort prej dhemonit dhe pak orë më pas u shërua fare dhe lavdrononte Zotin dhe shenjin.

Një nga xhelatët që vranë Shën Kozman kish-të marr punokalimafqin e tij dhe kur u këthye tek hoxha e vuri në krye për të përqeshur Shenjin, po q' atë çast u dhemonis, nxori rrrobat e tij dhe briqhte tue britur dhe tue thënë se ai është vranë asqi-,  




tin. Pra kur e mori vesh këtë gjë Pashaj, dha urdhër dhe e vunë në ekrat, ku vdiq shum liksht si i lik që ishte.

Shën Kozmaj kur bëri predikimin e fundit në katundin e sipershënuar të Kolkondasit, kishte lë-në atije, simbas zakonit t' tij, një kryq, të ngulur në dhe. Pra dhe pas vdekjes të Shenjtit të Krishterët shihnin natë për natë një drit qellore që shkel-qente mbi Kryqin, dhe ditën e ngritjes të Kryqit shenjt vajrën atije priftrinjt bashk me gjith popullin dhe me evllavi të madhe dhe litanira e muarën atë kryq dhe e vendosën prapa Jodhimës, afër varrjt Shën Kozmajt, që të qendronjë për kujtim të gjithnjëshëm të çudis.

Nxënësit e Shën-Kozmajt, pasi muarë i liri të plot nga Pashaj bënë anakomidhin të aliosanës së shenjt dhe ca nga ta muarën pjesa prej saj dhe i shpërndan në vise të ndryshme. Me fuqin e këtyre u shëruan shum të sëmur Sidomos në Nisin Nakson, ku vajtën dy nga nxënësit për të informuar të vllan e shën Kozmajt Hrisanthin, i cili ishte drejtor i shkollës asaj nisie, qëlloj të kishin me vëhte ca qime nga mjekra e Shenjtit Pra një grua n-a katundi Neohori, e cila pësonte për vdekje prej një sëmundjeje shum të rënd, pora që mori në dorë këto qime, ndjeu çuditërisht rë vëhten e saj një fuqi të përmbinaturëshme, me anën e së cilës për pak kohë gjeti shërim të plot. Gjithashtu dhe shum gra që nuk pillnin, tue marr dyzet ditë radhazi Dhë nga varri i shenjtit, i arritën dëshirës së tyre, do-

methënë bënë fëmij me hirin e Zotit Krisht dhe me lutjet e Dëshmorit Shën Kozma, me ndërmjetimet e të cilët na meritoft Zoti të hyjmë në Mbretërin e tija qellore. Amin.



Këtu posht botojmë dy letra të Vezir Ali Paشا Tepelenës, të marruna nga arhivet e Mitropolisë Beratit dhe të botuara në faqen 82 të librës të ndyerit ish Mitropolit të Beratit Anthimit.



### Apo ton Ispilotaton Vezir Ali Pashan

Is esas Romei tu Beratiu, muzaqaridhes qe Vlahi Grabovaridhes, Horia qe Çifliqiz. Sas fanerono ja opu evala epitropon dhia na mu ftiasi to Monastirion tu Gjero Kozma qe evoithisa qe ego aspra, qe na voithisite qe sis kathos na sas pi o Dhespotis, dhja na ftiasthi afto to Monas irion. Qe opios na mi voithisi theli mu apomini to hatiri qe isteron tha ta plirosite dhipla. Kathos sas prostazo eci na akoluthate eks apofaseos.

Tin 12 Septemvriu 1813, Argjirokastro.

Letra e dytë:

Alis.

Hair duaxhidhes mu Mitropoliti tu Beratiu qe Koli Mitru qe Haxhi Janko. Sas herete qe sas fane-rono oti ekatallava ta osa mu grafete ge egjina vukufis qe apo ton igumenon qe to ekama hazi poli opu egjinikatan mukaetidhes dhja ton gjero Kozma. Ja opu erhete tora aftu o igumenos qe o Nikollaos mazi me ton protomastora qe na valete na ftiasi tus odadhes qe to kulluri tu Monastiriu opu na gjeni teqmili apo ola ta Monastiria, oti tora me to elthimo thelo eltho eqi qe thelo na to evro etimon, imuna pashisite oli sas na to ftiasite qe oli i romei tu Beratiu na voithisun mikri qe megali qe grafo qe tu Ibrahim Arapi dhja na sas kami musaeden se kathe dhulja. Kathos sas grafo na kamete qe igjenete.

1814 Septemvriu 12 Ioannina.



## Kthimi i Letravet Shqip

Nga lartësi e tij Vezir Ali Pasha  
Tek juve Rum të Beratit, Myzeqar dhe Vlehë  
Grabovarë, Këtunde dhe Çifliqe.

Ju lajmëronj se ja tek vura një epitrop që të  
më ndreqin Manastirin e Plakut Kozmajt dhe ndih-  
mova dhe un me të holla dhe të ndihmoni dhe  
ju si t' ju thot Dhespoti, me qëllim që të ndreqet  
kjo Manastir.

Dhe për ata që nuk do të japid ndihmën e  
tyre, do të më mbetet atëri dhe do t' i paguajnë  
dyfish.

Sikundër ju urdhëronj kështu të bëni, pas kë-  
tij vendimi.

Në Gjinokastër më 12 Shtator 1813

Letra e dytë:

Hair duaxhit e mij Mitropolit i Beratit dhe  
Kol Mitro dhe Haxhi Janko.

Ju salutoni dhe ju kallzonj se sa më shkruat  
i mora vesh dhe u informova dhe me anën e Igum-  
enit dhe u gëzuaç shum që u kujdesët për Pla-  
kun Kozman.

Ja tek po vjen aty tanë Igumeni dhe Nikolla  
bashk me kryemjeshtrin dhe të vini të ndreqin o-  
dat dhe kullan e Manastirit që të shquhet nga të  
gjith Manastiret, sepse tash me ardhjen time aty,  
dëshëronj t' a gjeni të mbaruar.

Pra të kujdeseni të gjith që t' a ndreqni dhe  
të gjith Rumët e Beratit, të mëdhenj e të vegjel të



ndihmoni.

Po i shkruanj dhe Ibrahim Arapit t'ju 'ndihin në ç do punë. Të bëni sikundër ju shkronj. Ju përshëndet.

Në Janin më 12 Shtator 1814.

## Létra e Shën Kozmajt përtë Krishterët e Senicës:

Evgjenestati agapiti adhelfi, i katikuntes tin horan Senican sas aspazome qe parakalo ton agjon Theon dhia tin psihikin qe somatiqin sas igjian.

Ego os dhulos anaksios, adhelfi mu hristiani, tu Theu imon, perierhomenos qe dhidhaskon to kata dhinamin tus hristianus me adhian ton arhie-reon iltha qe edho qe is tin horan sas qe vlepon oti dhen ehete skolion na dhiavazosi ta pedhja sas horis pliromin, eparekalesa tus hristianus qe edho kan to kata dhinamin qe proeresin dhia to skolion sas. Prepi dhe qe i evgjenia sas qe pantes na voin thisite pantote to skolion sas eks idhion ponon, iqinos apo tin horan i apo vakufia dhia na lavite, qe para Theu ton misthon sas qe timin para anthropon.

Ime dhe qe ego hreostis na parakalo ton Qirion na evllogjisi tin horan sas, to skolion sas qe ta pedhja sas qe na sas aksiosi na zisite qe edho kala qe thearesta qe na sas vali is ton paradhison, na heristhe qe na efrenishte qe na dhoksasite tin agjian Triadha.

Evala dhe qe Epitropon me tin gnomin pan-



ton ton qir Lekan tu Qirku qe epistatas qe voithus olin tin horan, malista dhe ton Papa Qir Nikan qe ton Qir Gjinon Dhimu qe ton Qir Spiron Dene qe ton Qir Spiron Athanasiu na qivernisosi to skolian kathos o Qirios tu fotos tus fotisi.

Tafia qe igjenete en Qirio.

1779 Juliu 28.

Kozmaš Jeromonahos Efhetis sas.

## Kthimi Shqip i Letrës Shën Kozmajt për të Krishterët e Senicës.

Vllezër të nderçëm e të dashur, që banoni në qarkun e Senicës, ju përshëndet dhe i lutem Perëndi: së Shenjt për shëndëtin tuaj shpirtënor dhe trupën or.

Un shërbëtor i pa dinjuarshëm, i Perëndis o vllezër të kri hterë, tuke shëtisur dhe tuke i u predikuar të krishterët me lejën e Mitropolitvet, erdhë dhe këtu në viset tuaja, dhe tuke parë se nuk kini shkollë që të këndojnë djemt tuaj pa pagesë, i u luta të krishterët dhe dhanë gjithsecili pas fuqis dhe pas dëshirës së iij për të ndrequr shkollë. Duhet, pra, që dhe Zotënia juaj dhe të gjith t'a ndihmoni këtë shkollë gjithnjë, ose vet ose nga të ardhurat e komunitetit a të vakufëvet, që të merni shpërblimin nga Perëndia dhe ndër në mest të njerzvet.

Dhe un jam i detyruar t' i lutem Zotit të bëkonj vëndin, shkollën dhe djemt tuaj dhe t' ju dënjonj të rroni dhe këtu mir dhe të fitoni jetën e



— 30 —


arthme.

Vura dhe epitrop Qir Lekën Qirku me dëshirën e të gjithve. Sa për kujdestarë dhe ndihmës caktova gjith vëndin dhe sidomos Papa Nikën, Qir Gjinon Dhimu Qir Spiro Deje dhe Qir Spiron Athanasiu, që i' a qeverrisin shkollën si dëshiron Zoti i drites.

Ju përvendet në emrin e Zotit.

1779 Korrik 28.

Kozmas Jeromonahos, lutësi juaj.





## Në mbrëmësoren. Vargësore të përshëmbëllta të Shenjtit.

Poiois Ephemion stemmasin.

Ejani, Gjini mendonjëse e njerzvet, të formojmë një korë të bashkët dhe të këndojmë me ngazëllim Kozman e Hyshmë, stoli të Gjinis së të vdekëshmvet, pris dhë mësuësin t' onë të math. Se shkëlqeu në dituri e në vepra dhe me fjalime të ndriçme e mësime të larta udhëhoqi gjindjen në dijën e Perëndis; u dëftyeshëmbell i asqitinjvet dhe Jerodëshmor në mest t' Apostujvet.

### Tjetër e përshëmbëllt. Dy herë.

Ejani, Shoqëri e Orthodhoksëvet, të lëvdojmë adhuronjësin e Krishtit, shëmbell mirëbesimi, sedruës të anargjirvet dhe të harabart me Apostujt. Se na pasunoj me dijën e Perëndishme dhe zbulkuoj sielljet e të gjithve; derdhi darovisht mësimet, u shqua në mest të priftërvet dhe mori kurorën nga Krishti që ka përdëllimin e math.

### Tjetër e përshëmbëllt. Dy herë.

Ejani të gjith besnikët, me lulet e zgjedhura të lëvdatavet, të gërshtojmë një kurorë dhe detyrisht të kurorëzojmë kryet e shenjt të shërbëtorit të Krishtit; se buron pasunisht hirë për ata që i qasen me shpres dhe dëbon sëmundjet e ndryshme me fuqin çudibërëse që i dha Krishti, Përdëllonjës' i math.

### Lavdi. Tingull i tërthor II.

Pagendruarëshmin e punvet të kësaj bote the-



Ilësish e studiove, o Shenjt, dhe more mbi cupat e tua kryqin e Krishtit. Mbolle apostolikisht farën e besës dhe na dhurove rrafshësish hirin e shërimet. Posi shën Pavli u thërisnje të gjithve: Doni Perëndin që të gjeni preje në shpirtet tua ja bashk me Shenjtorët. Pra, tani të lutemi, o stoli e dëshmorvet, me guximin që ke pranë Zotit shpëtimtarit t' onë, mos pusho së ndërmjetuari për nç, që vijmë me shpres përpara alipsanavet t' tua të shenjtë dhe me bes festojmë kujtimin tënd.

Tani e përherë.

Kush të mos të lumnonj, o virgjëreshë e tërshenjt?

## Paravargu dhe Këndimet:

### Këndim nga Profitit e Isaisë:

Këto thot Zoti: Gjith Kom'bet u mblorehën së bashku dhe do të mblorehen prisët e tyre. Kush do të lajmëronj, a kush do t' ju a bënj këto të ditura? Le të sjellin dëshmimtarët e tyre, le të improjnë vehten dhe le të thonë të vërteta. Bëmuni dëshmimtar dhe Un Zoti Perëndia jam dëshmimtar dhe djali që kam zgjedhur, që të dini e t' më besoni dhe të merni vesh që Un jam. Përpara meje: nuk ka pasur tjetër Perendi dhe pas meje nuk do të ketë. Un jam Perëndia dhe përveç meje nuk ka tjetër shpëtonjës. Un ju lajmërova, ju shpëtova dhe ju qertova, se nuk ishjam i huaj ndër ju. Ju dëshmimtarët e mi dhe Un Zoti Perëndia. Se që nënisje Un jam dhe nuk ka kush mund të shpëtoni nga duart e mia. Atë që bënj Un kush mund t'a



kundërshtonj? Kështu thot Zoti Perëndia, shëbhe-njësi yn? Shenjti Izrail.

### Këndim nga Profitit e Solomonit:

Shpirtet e të drejtvet janë në dorë të Perëndisë dhe nuk do t' i prekin mundim. Në syt e të marrvet u duk sikur vdiqën; dalja e tyre ngajeta u quajti si ligështi dhe ikja nga ne, si prishje. Po ata gjenden në lumni. Se dhe në u mundofshin përpëra njerzvet, shpresa e tyre është plot me pavdekëshmi, dhe pas vuajtevet të pakta do të kenë fitime të mëdha. Se Perëndia i sprovoj dhe i gjeti të dinjuarshëm për vehten e Tij, i sprovoj si ar në honeftir dhe i priti si theror të shumpërmëshëm dhe në kohën e pushtetit t' tyre do të rindriçojnë dhe do të përrandin si shkëndira të zjarrita. Do të gjykojnë Kombe dhe do të zotënojnë mbi popuj dhe Zoti do të mbretëronj mbi ta për jetë. Ata që i janë besuar do të kuptojnë të vërtetë, dhe bestarët do të qëndrojnë pranë Tij në dashuri. Se hirë dhe mëshirë është në oshenarët e Tij dhe pushtet në të zgjedurit e Tij.

### Këndim nga Dituri e Solomonit:

Të drejtët rrojnë për jetë, shpërblim' i tyre është pranë Zotit dhe janë nënë kujdesin e të Lartit. Prandaj kanë për të marr nga dor' e Zotit Mbretërin e hijeshmis dhe kurorën e bukurisë; se me të djathtën e Tij do t' i mbulonj dhe me krahun e Tij do t' i mbronj. Do të mar si panarmi zelin e Tij, dhe do të armatosin kriesën për të lëftuar ar-



miqt. Do të veshin oshenari si mburoj të pamundëshme dhe do t'a pres zëmëratën e tij posи shpath. Bota do të lëftonj bashk me të kundra të marrvet. Nga retë, posи nga një ark i rrumbull, do të ikin shtiesa shkreptimave dhe do të goditin në qellim; Nga zëmërata e Tij breshërit do të bjen si gurë. Do të pizmatoset kundra tyre ujët e detit dhe lumenjt do të inondojnë rreptësisht. Erë e fuqishme ka për të qendruar kundra tyre dhe shtërgata i ka për të dërrmuar. Paudhësia do të shkretetonj vëndin e tyre dhe keqbërja do të përbysin fronë të fuqishmëve.

Dëgjoni, pra o Mbretër, dhe vëmëndni; Merni vesh gjyqtarë an' e mban të dheut. Dëgjoni ju që zotënoni mbi popuj dhe krenoheni mbi turma kombesh; se na u dha prej Zotit zotënimini mbi ju dhe pushteti na u dha prej të Lartit.

### Liti. Tingull i I.

Ç' të të quajmë, o i tërlumtur? Dëshmor, se derdhe gjakun tënt për Krishtin? Predikonjës, se predikove Mbretërin e qellit? Apostull, se fjalën e Ungjillit apostolikisht e ligjërove? Asqiti, se jetën tënde e dëfteve si pasqyrë të pastërt të asqitismës? Meshtar, se i ofrove Zotit vehten si theror të dli-ri? Lut-i-u për shpëtimin e shpirtevet t' ona, që festojmë përvjetoren tënde të shenjt.

### E përshëmbëllt.

O Jerodëshmor i lavduruarshëm! kush mund të rrëfenj përpjekjet e shkëlqyera që bëre për besën? apo djersët dhe mundimet që vuajtë për të



predikuar në ç' do qytet fjalën e Krishtit? Prandaj more prej Tij trashëgimin e qellit. Të lutemi, pra, me guximin që ke pranë Zotit, ndërmjeto për pagen e shpirtëvet i' ona.

### E përshëmbëllt.

Me mundime të trupit dhe largim nga pasionet jetën tënde e dlirove dhe udhën apostolikisht e mbarove. Prandaj Krishti, që nderon lavduronjësit e Tij, të dhuroi rrafshësish hirin e çudiravet. Tani dhe ne, alipsanat e tua të shenja që janë burim shërimi, i puthim me bes dhe të lutemi. Ndërmjeto për faljen e mekatavet t' ona dhe shpëto nga Ferri nderonjësit e tu.

### E përshëmbëllt.

Ti që me të falurit tënd spastrove me një fjalë ujërat e fëlliqura dhe ngjinde popullin me ujë të kulluar, dhe shpirtin tim të përlyer dlirohe me lutjet e tua, o shenjt. Si ujë të kulluar parashtroja Perëndisë, që dëshëron shpëtimin e mekatarvet dhe i dhuron botës përdëllimin e math.

### Lavdi. Tingull. i T. I.

O At oshënar, tuke ecur gjithmonë në gjurmët e pasonjësve të Krishtit, jetën tënde evangjelikisht e mbarove. Neverite botën dhe dëfrie saj dhe jetën e shpërfille që të fitoç vlezërit dhe të afërmët e tu për lumenin e sipërme. Për shpëtimin e tyre derdhe gjaku si Krishti dhe dorëzove vehten shëlbim për të shumët. Prandaj kombe të paditur i shpure tek Zoti që të hyç bashk me ta në Mbret-



tërin qellore tuke thirrur: Ja un dhe djemt që më dha Perëndia.

### Tani e përherë. E përshëmbëllt.

Ty të lumnojmë virgjëreshë Perëndilindëse dhe të lavdurojnë detyrisht besnikët; kështjellën e patundur, tabjen e papërçarëshme, mbrojtjen e pa-thyer dhe sigurimin e shpirtevet t' ona.

---

### NË VARGUN. TINGULL IV.

#### Os gjennaion en Martysi.

Luftëtar i pamundurë me fuqin dhe hirin që more që lartazi dolle mundësë. Ç' do mendim të armikut, Kozma i çudiçëm, e rrëzove guximisht me fjalime të hyjeshme dhe të ndritëshme, dhe tropera të mundjes kudo ngrite dhe mbarove këtu jetën, i kurorëzuar me kurorë të pafikur.

#### I çudiçëm ësht Perëndia në shenjtorët e Tij.

Me mësime të hyjëshme dhe fjalime të larta tër botën vadite, o i tërlumtur. Mbolle farën e besës në zëmrat e njerzvet të paditur, dhe të gjith, si kallinj të mbushur dhe pemprurës me virtuta të stolisur, i udhëhoqe ti tek Krishti, i çudiçëm, si një theror të mirpritur.

#### Me anën e shenjtorvet t' Tij, që janë në Dhé, Zoti bëri çudira.

Në ç' do virtutë shkëlqeve ti, o mburrim i dëshmorëvet dhe stoli e çmueshme e aşqitnjëvet, shëmbëll e lart e mirsjelljes dhe banim i Trinis;



Pranë Asaj ndërmjeto tani për besnikët, që t' na falen mekatat dhe t' na jepet shpëtimi dhe përdëllimi neve që të nderojmë me bes.

### Lavdi. Tingull i terth. IV.

Gjindjet e besnikvet të nderojmë ty udhëheqësin t' onë të lart, o Kozma i shenjt. Se me anën tënde mësuam të baresim në udhën e drejt. Lum ti që i shërbeve Krishtit dhe me fjalimet e tua i shpure Perëndisë shumicë besnikësh si theror të erëmirëshme. Shoqëronjës i engjevet, shëmbëllnjës i Apostujvet, bashkndenjës i dëshmorvet dhe të drejtvet; Ndërmjeto me ta për shpëtimin e shpirtvet t' ona.

### Përlëshore Tingëll i IV.

Të bashkuar në kremitimin e të përkujtuarshmit Kozma, të gjith me përvujtëni le t' a lëvdojmë, o besnik, shkëlqim të dëshmorvet, mburrim të mështarvet dhe të murgvet. Ai, si isapostull dhe si mbrojtës pranë Krishtit, u fal shërime të sëmurvet që i qasen me bes.

## TANI E PËRHERË. TJATËR PËRLËSHORE

### Tingëll i III. Efrainestho ta urania

Ti në Botë Kozma shkëlqeve posaçëri i tërndritshëm; si në qell mbi Dhë jetove dhe shpërndave natën e errët të pabesimit. Prandaj dhe ne, me lulet e erëshme të këngëvet, të gërshtetojmë një kurorë dhe me shpres të thërrësim: O stoli e dëshmorvet! mbulo besnikët me hirin tënd dhe shpëtona nga rrreziket.



## NË MËNGJES.

Zoti Perëndia.... Përlëshore e shenjtit. Tani e përherë. Përlëshore e dytë e shenjtit. Pas vargut t' parë këto ndënjosore në tingëllin e I.

### Ton Tafon su Sotir.

Me besën e Krishtit, si një armë të pamundur, dolle mundës kundra gjith armiqvet. Fjala jo-t', o shenjt, pos i shpathë e prehtë, preu rrënjet të pabesise dhe rrëzoj qëllimet e të ligut.

### Tani e përherë. Perëndilindësore.

Nëne të Perëndis Ty të njohim të gjith ne, që me shpres gjejmë sigurim në mirësin tënde; se virgiér e vërtet dhe pas pjelljes u duke. Ty të kemi mbrojtëse të gjith mekatarët. Ty të kemi shpëtim nga ngasjet e të ligut, të vetmën të purrekëshme.

## PAS VARGUT I' III TINGËLL I TERTH. I.

### Ton synanarhon Logon.

Farën e mirbesmit në zëmrat e njerzvet e mibolle, oshënar, dhe korre pemët e mësimevet t' ua si dhemate kallnjësh. Si një theror të kënd e-tshëm i shpure Krishtit gjindje të panumërt, që mburrehen tuke ruajtur Orthodhoksin e dogmavet.

### Tani e përherë. Perëndilindësore.

Gëzohu dera e Zotit e pa' aluarëshme; gëzohu kështjell dhe mbrojtje e atyre që rendiu tek Ti; gëzohu limani i sigurt, nus' e pamartuar, që linde rupërisht Perëndin, Kriatorin tënd. Mos pusho së përmjetuari për ata që për ymnojnë dhe i falin

Birit-tënd.



### Perëndilindësore:

Ata që të njojin me të vërtet Perëndilindëse, mbrojtje të gjith njerzvet dhe ndëmjetonjëse pranë Atij që linde, shpëto-i o e tërlumnuarshme; se të gjitha për Ty janë të mundura, që linde foshnjë Kriatorin, Zotin që ësht parajetvet.

### KËNG' e III.

#### O stereosas kat arhas.

Shpirtin tim të përlyer nga pasionet e fëlliura gëzohe me lutjet e tua dhe ndriçohe me dritën e dritës së hyjëshme, që të lavduronj dhe un atë që të nderoj, o i lumtur.

Mëndjen tënde e dlirove me sjellje të mira dhe e ngrite tek Perëndia, o shenjt. Meshtar i mbaruar rende pas Krishtit dhe i ofrove gjakun si theor të mirpritur.

Arën e palëvruar të shpirtit tim dëftehe pemprurëse të virtutavet me lutjet e tua, o shenjt. Kefuqi dhe pas vdekjes t' u bëç çudira atyre që u vijnë alipsanavet t' tua me shpres.

### Perëndilindësore.

Mëndjen t'ime të errur nga shtërgat e pasionevet gëzohe, o virgjër, dhe ndriçohe me dritën e Atij që lindi nga Ti, që të mund t' a lavduronj, dhe Ty të hymnonj të pacinuarshmen.

### NDËNJËSORE. TINGËLL i II.

#### Epefanis simeron.

Lumënjt e pabesisë i tërë, kur u hodhe në



rrymën e lumi, o i pamundur luftëtar, dhe me kurorë të pafikur kalove, i përkujtuarshëm, në jetën e amëshuar.

### Perëndilindësore.

Ti që linde dritën të paperënduarshme ndriço syt e errët të shpirtit t' im dhe shpërndahe mjegullën që rri dëndur mbi zëmrën t' ime, o Zonj.

### Këng' e IV. Sy ei to stereomà.

Gjeça mëshirë pranë Zotit me lutjet e tua, o shenjt. Guximi yt pranë Trinis ësht i math, se u tregove adhuronjës i Saj.

Të paça ndërmjetonjës pranë Zotit, i tërlumtur, për shpëtimin nga mjerimet dhe faljen e mëkatavet.

Dëshmor i tërlumtur, që u therorove për Krishtin, ndërmjeto dhe për mua që të çfaqem faqebardh përpara Tij.

### Perëndilindësore.

Përdëllonjës të t' Bir kundrejt meje tregohe, o Zonj, me ndërinjetimet e tua të tërfuqishme.

### Këng' e V. Ina ti me aposo.

Shenjtërove ujërat kur u hodhe në lum, dhe tri ditë, si Zoti, qendrove brënda në to, o At. Ndërmjetso dhe për ne që të shpëtojmë nga Ferri.

Me mëndjen tënde të ndritur me dritën e Trinis, Trinin predikove botënisht; një substancë në tri Persona, të Atit, të Birit dhe të Frymës së Shenjt.

Kotësit kundërmonjëse të kësaj jete, o At, i këmbeve me myron e Trinis së tërshenjt. Rende



pranë Zotit dhe i ofrove gjakun si theror të pëlqy-  
ershëm.

### Perëndilindësore.

Ti që linde dritën ndriço dhe zëmrën t'ime  
të errët me dritën e shkëlqyer të Trinis së tridritë-  
shme. Veç teje, pranë Krlshtit, nuk kam tjatër ndërmjetonjës.

### Këng' e VI. Ilásthiti moi Sotir.

Me fjalë të këndëshme, i lumtur, binde të gjith  
besnikët dhe i tërhoqe në dijen e Perëndisë. Njof-  
tuës të mirbesimit i bëre mosmirnjojtësit.

O meshtar i Perëndisë! Për atë therorove veh-  
ten dhe kungove në pësimet e Zotit, që të jetosh  
me të në Mbretërin qellore të pavdekur.

Udhëheqës të murgvet, shëmbell të meshtarvet  
jetën tënde e dëfteve, o Shenjt. Me ndërmjetimet  
e tua u kthefshim dhe ne në dijen e Perëndisë nga  
udh' e ginjeshtrës.

### Perëndilindësore.

Të lutemi, o virgjëreshë, burim përdëllimi,  
ndërmjetso dhe për ne që të gjejmë mëshirën në  
ditën e gjyqit dhe falje të mekatavet.

### Shkurtësore.

Në Etoli linde Perëndimbajtës dhe në Atho, si  
murg, hyre thellësisht në mysteret e lavdis së Pe-  
rëndisë. Predikove fjalën e së vërtetës dhe udhëho-  
qe të gjith tek Krishti, tuke imituar Apostujt me  
derdhjen e gjakut tënd.

### Oikos.

Bukurin e dëshmorvet, mburimin e murgvet,



predikonjësin e besës dhe shëmbëll të priftërvet, imitonjësin e mbaruar të Apostujvet, le t' a nderojmë, o besnik, dhe le të kurorëzojmë kryet e tij të shenjt me lulet e lëvdatavet. Ajo bën çudira dhe u derth pasunisht sherimet atyre që i qasen me shpres. Le t' a puthim, pra, dhe le t' i thërresim:

Gëzohu ligjëronjës i besës, shtyll i patundur i Kishës. Me ndërmjetimet e tua mbahe Kishën në paqe, se ke guxim pranë shpëtimtarit Zot, si gjurmës i Apostujvet. Të gjan të jeç në korin e dëshmorvet, se derdhe gjakun për triomfin e besës.

Më 24 të muajit kremtohet kujtimi i Atit t' onë shenjt Kozma, Jerodëshmor dhe Isapostull.

Kozmaj, stolia dhe bukuri' e Botës

La Botën e përkohëshme dhe hyri në të përjetëshmen.

Më 24 të këtij muaji Kozmaj mbaroj jetën, tuke u varur me litar.

### Këng' e VII. Paidhes Evreon.

Gjumat e këmbvet t' tua me ato të peshkatarvet i mbajte, o i tërlumtur, dhe me rrjetat e fjalvet t' tua peshkove shpirtat e njerzvet dhe i nxorenga gremin' e prishjes.

Të udhëhequr me fjalët e tua, njohem Fjalën e Atit, një prej Trinis, qe për me na përtëritur, mori formë njerzore.

Mburrehet Etolia me shkëlqim, që biu meshtarin e math të Perëndisë, stoli të Botës, qe positi trënpafil, derth erë të këndëshme në gjith besnikët.

### Perëndilindësore.

Gëzohu shpëtim i njerzisë që lindë Zotin e të



gjithave. Lut-i u gjithmonë për shërbëtorët e tu, që kërkojnë me shpres mbrojtjen tënde, o Zonja jonë.

### Këng' e VIII. Ton en orei agjio.

Priftër dhe dëshmor ty të lëvdojnë, o Kozma i shenjt, dhe gjindja e murgvet me hymne të këndojnë, se me diturin tënde u tregove i barabart me Apostujt.

Fjalën tënde dërovisht e mbolle në zëmrat e etuara të njerzvet dhe për mundimet e tua more prej Krishtit kurorë të pafikur. Mos pusho së ndërmjetuari për ne.

Të ndritur nga mësimet e tua të Perëndishme Shqiptarët të lëvdojnë dhe në Kishën tënde të shenjt lavdurojnë. Trinë që të nderoj.

### Perëndilindësore.

Me anën tënde Perëndilindëse hym prap në paraisin e humbur. Marçim falje të mekatavet me ndërmjetimet e tua.

### Këng' e IX. Eksesti epi tuto o uranos.

Me shpirt të ndritur nga shkëlqim' i Hyjinis u hodhe në luftimet, tuke u përpjekur për shpëtimin e të gjithve. Kënaqësisht e dhé trupin në mundime, tuke ecur në gjurmat e t' yt Zoti.

I pasuruar me dituri të lart dhe frik Perëndie, udhëhoqe besnikët në dijen e hyjeshme, i mësove të lavdurojnë një Perëndi, Trini në njësi, Atin panisje, Birin dhe Frymën e Shenjt.

### PAS POLIELEUT. TINGËLL i II.

#### Epefanis simeron.

Të mbledhur sot të gjith me bes në Kishën



tënde, lëvdojmë përpjekjet e tua të ndriçme, o Je-rodëshmor. I përunjemi me shpres alipsanavët t' shenja dhe marrim shërim të sëmundjevet dhe të hidhërimet.

### Tani e përherë. Perëndilindësore.

Ti o Zonj që linde shpëtimin e Botës dhuro-i-u shpëtimin dhe hymnitarvet t' tu, se të gjitha të janë të mundura. Mos pusho me e zbutur për shërbëtorët e tu, që të na shpëtonj nga zjarri i Ferrit.

### E njëzëshme. Tingëll i II.

Që në djalëri i u dhe mundimevet dhe studimet të punvet të Perëndisë dhe ngrite mëndjen tën-de në të përmbibotëshmet. Nga Athoni u nise si një herë moti Niloja, me fjalët e tua vadite shpirte të etuara dhe i dëfteve pemprurës me dijen e besës. Prandaj dëgjove zërin e Krishtit të të thot: Hyrë, o shërbëtor i mir, në gjëzimin e t' yt Zoti.

### KANUN I PERËNDILINDËSES DHE I SHENJTIT.

#### Këng' e I. Tingëll i terth. IV. Armatilatin Farao.

Si meshtar i thjesht i Zotit dhe pasojës i Apostujvet, besën e vërtet botënisht e predikove; o shenjt, dhe me fjalët e tua udhëhoqe të gjith në besimin e Perëndisë dhe në dijen Orthodhokse të dogmavet.

Kryqin e t' yt Zoti e mbajte në gjith jetën tën-de, o shenjt. Me fuqin e tij, u bën çudira të panumërtë atyre që vijnë me shpres. Ndërmjetso që të ruhem i me anën e Tij nga goditjet e armikut.

Jetën tën-de e dëfteve shëmbell virtutave për asqitnj, priftër dhe dëshmor, o i diçëm. Këtij tre-



gulli të palajthitur i vajçim pas dhe ne që të gjejmë shpëtim.

Si kujtim të fjalimevet, o Kozma, linje Kryqin e hijeshëm, mbi të cilin i Drejti nderi duart për shpëtimin e Botës. Me anën e Tij bënje çudira dhe u dhuronje shërime të gjith besnikvet.

### Perëndilindësore.

Një herë moti Moisiu të parashikoj si një fëtë që digjësh pa flak, o Virgjëreshë. Po ne si Perëndilindëse të vërtet të lavdurojmë dhe të kemi ndërmjetonjëse pranë Birit tënd dhe Perëndisë s'onë.

### Eksapostilarion. Gineqes akutisthite.

Kryqin ti të Krishtit e ngrite mbi çupat e tua dhe me anën e Kryqit bëre çudira të mëdha, shërime të sëmundjevet, o meshtar i mbaruar.

O Maria, Zonja jonë, mos pusho të ndërmjetosh për shërbëtorët e Tu pranë Atij që linde vet, se ke fuqi për sa dëshiron o Nën' e Mbretit.

### NË LAVDËRIMET VARGËSORE TË PËR-SHËMBËLLTA.

#### Tingëll i I. Ton uranion tagmaton.

Me fjalime të hyjëshme ligjërove besën. Me dritën e Trinis që përhape në Botën shpërndave errësirat e ginjeshtrës, i lumtur Kozma. Pranë Asaj ndërmjeto pa pra për ne që me bes dhe përvujtëni festojmë sot kujtimin tënd të shenjt.

Alipsanat e tua çudiburonjëse, i mban me mburrese qyteti i Beratit, në gjirin e tija, posa tezar të pashterrur të çudirave. Me urimet e tua, pra, e shpëto nga ç' do dëm i amikut o Shenjt.



Dëfre sot me bes dhe ngazëllohu Berat, se ruan në gjirin tënd oratorin e lart, Kozman e Perëndishëm që është nder dhe lavdia e Kishës s'onte, stoli e meshtarvet dhe mburrim i dëshmorvet dhe i murgvet.

### Lavdi. Tingëll i II.

Le të lëvdojmë, o vlezër, isapostullin Kozma, zelltar të Pavlit, enës së zgjedhur dhe të parit të Apostujvet. Se nuk shijoj gjum dhe preje nga mundimet gjer sa u përhapi të gjithve fjalën e Ungjillit. Zëmrat e besnikvet i nxori nga gremin e gjinjeshtrës dhe i udhëhoqi në dijen e hyjëshme. Me ujën e fialvet t' tija vaditi shpirtet e njerzvet dhe shpërndau errësirat me dritën e ëmbël të Trinis. Ndriçona dhe ne me atë dritë, o shenjt; që të ruhemti nga laktet e armikut.

---



## Pasthënije e kthenjësit.

Posi një nga komitet, që nga një kohë në tjatër çfaqen në kubën e Qellit, derdhin dritë të shkëlqyshme dhe çduken shpejt, kështu prezantohet përparrë nesh dhe fytyra e ndriçme e Shën Kozmajt.

Kjo Shenjt nuk ishte nga ata fetarë e kallogjerë të paditur e mëndjengusht, qe, të ngjitur në letra të vdekura, harrojnë fryshtë e vërtet të besimit fetarë. Ai ishte një njeri me kultur, me orizonte mendor të gjërë dhe, naturisht, me mendime fetare të larta.

Kjo gjë duket qartë si nga veprat ashtu dhe nga jetëshkrimi i tij, i shkruar, në origjinal, prej një admiratori t' tij. Këto na japidnë të kuqtojmë se Shën Kozmaj ishte njeri me vullnet të fort dhe me aktivitet të palodhur. N' ato kohëra kaq të zorshme të frikës, ai, me mundime të mëdha dhe me rezikë të patreguarshme, shëtisi an' e mban Shqipërin; Derdhi pasunisht dritën dhe mësimet e tija të çmuëshme, dhe u përpoq që të forconte, të inkurajonte popullin e dëshpëruar. Me anën e këtij aktiviteti mundi me e shpëtuar dhe me e përbajtur.

Po qysh i arriti vall këtij qëllimi?

Tuke përhapur dritën në popull, tuke çelur shkollat gjithku dhe tuke bindur popullin që t'i mbante këto me ç' do therori. Dhe kjo është meritë e tij më e madhe.

Si një njeri me kultur të gjërë ai e dinte që kjo ishte e vetmja udhë për të formuar në shpir-



tin e popullit një fetarismë, jo të dukshëm, po të gjallë, të thjesht dhe të çliruar nga prezhyzherat.

Ësht e vërtet! Pa dije nuk mund të ekzistonj dhe idhë fetare e thjesht. Padja ësht rrënja e shum ligësiravet; po më tepër ajo ësht nëna e supersticionëvet të errëta.

S' ka dhe s' mund të ketë besim dhe kult fetar të pastërt pa mësim.

Le të hedhim një vështrim në popullin t' onë. Me hidhërim do të vërejmë sa ësht dezheneruar në një shumicë të tij idhea fetare dhe gjer në ç' gradë ajo e ka humbur karakterin e saj të lartë dhe influencën bamirëse. Ajo në vënd që i ë jetë burim aktiviteti të gjallë, të çfaqur në vepra të hijëshme, në njerzillëk, përkandrazi krion në shpirtin e tij paralogjisme të rezikëshme.

Për një të paditur Fé domethënë ceremonira, zakone dhe formalitete. Atij i duket se kur mbani këto, i ka mbaruar të gjitha detyrat fetare. Këto supersticie, trashëgim i një të shkuare të gjat, që kanë pushtuar shpirtin e një shumice të popullit, i përgjajnë Hydhrës mythologjike, së cilës, kur i pritësh një kokë, binte në vëndin e saj një tjatër.

Po ësht vall kjo Fea e vërtet? Janë Fé supersticionet e paarësyshme e të errëta?

Kurr, Kurr! Inteligjecca e Lartë që drejton gjithësin e pajoj njerin me Arësy, që ësht zbulimi i tij i vërtet, një shkëndi e dritës së tij të amëshuar. Mbi atë dritë, pra, të rrjedhur prej Atij vet duhet të bazohet ç' do besim.

Fé nuk janë zakonet dhe supersticionet prapa-




nike, po sjellja e mir, singeriteti dhe nderi në reacionet me shoqi shoqin. Fé ësht me bërë detyrën, me i shërbyer njëri tjatrit; Fë sidomos ësht me u bërë therori për të mirën e përgjithëshme, për atdhen. Këto janë shënjat e thjeshta dhe të gjalla të Fés, dhe n' ato na udhëheq Arësy, e ndriçuar nga mësimi.

Ja përse Shën Kozmaj punoj për t'i frysmezuar popullit këto parime të larta; ja përse ai u përhoq që të përhapte dritën, të çeltë shkolla.

Këto parime ai i vërtetoj dhe me shëmbellën e tij të bukur dhe sidomos me mbarimin heroik, tuke ofruar jetën e vet si theror në alltarin e idealit që ndiqte.

Urojmë që ajo fytyrë kaq e ndriçme të qendronj gjithnjë e gjallë përpala syvet t' ona dhe të na kujtonj gjithmonë karakterin e lartë të Fés që ësht: Humaniteti dhe theroria, drita dhe përparimi.



ΔΙΕΥΘΥΝΣΙΣ

Tahta Minare Vodina Sokagi No 42  
Istanbul — Fenner

ΣΥΝΔΡΟΜΗ ΕΤΗΣΙΑ

ΕΝΤΑΥΘΑ ..... Λ. Τ. 2.50  
ΕΝ ΤΩ ΕΞΩΤΕΡΙΚΩ ..... ΔΟΛΛ. 2.50

Fazilet Başımevi, Galata